



MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Si trajtohen të dhënat tuaja personale kur bëni biznes me Lizingun?

Në ofrimin e shërbimeve tona ne kemi aplikuar rregulla strikte për të mbrojtur të dhënat e juaja personale në shkallën më të lartë. Duke zbatuar ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), ne vazhdojmë të mbrojmë dhe të përdorim të dhënat e juaja personale me një nivel shtesë të sigurisë dhe rregulla strikte të privatësisë, së bashku me një procedurë shumë transparente të përpunimit të të dhënave.

TË DREJTAT THEMELORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individit. Ky ligj përcakton përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për monitorimin e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.

Ky ligj është në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Europian GDPR 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizik sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave. GDPR (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave) i referohet mbrojtjes së personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave, me qëllim të nivelit më të

lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin dhe qarkullimin e këtyre të dhënave. Rregullorja është e zbatueshme në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Cilat të dhëna përpunohen dhe nga cilat burime vijnë?

Ne përpunojmë të dhënat personale që marrim nga ju në mënyrë që të ofrojmë shërbimet e lizingut të kërkuara. Përveç kësaj, ne i përpunojmë të dhënat që i kemi marrë në mënyrë legjitime dhe nga burimet që janë publikisht në dispozicion (p.sh. regjistri i bizneseve, regjistri i shoqatave, regjistri i tokës ose mediet) ose që ofrohen në mënyrë legjitime nga kompanitë e tjera të lidhura me institucionin.

Informatat personale që përpunohen dhe mbledhen përfshijnë:

- detaje personale dhe informata kontaktuese (p.sh. emri, adresa, data dhe vendi i lindjes, kombësia, etj.)
 - informata të identifikimit dhe dokumentit (të tilla si mostra e nënshkrimit, informata të ID).
 - të dhëna socio-demografike dhe të dhëna të punësimit
 - informata mbi kanalet e përzgjedhura të komunikimit me Leasing Albertin, përfshirë marketingun
 - të dhëna rreth marrëdhënieve të biznesit në lidhje me ju si një klient i Leasing Albertint.
- Pëlqimi juaj për Përpunimin dhe Përdorimin e të Dhënave Personale
- Duke nënshkruar pëlqimin për përpunimin dhe përdorimin e të dhënave, ju personalisht vendosni nëse dëshironi të pranoni që të dhënat tuaja personale të përdoren për qëllime të ofertave të individualizuara të krijuara posaçërisht, për marrjen e informatave mbi fushatat e fundit dhe ofertat më të favorshme.

Ju mund të nënshkruani deklaratën e pëlqimit në secilën degë të RBKO-së, dhe në rast se ndryshoni mendjen tuaj më vonë, mund të tërhiqni lehtësisht pëlqimin tuaj.

Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave dhe kë mund të kontaktoni?

Përgjegjës për përpunimin e të dhënave:

Leasing Alberti në Kosovë, Magjistratja Prishtinë-Ferizaj Km 4,

10000, Prishtinë

Telefoni +38349 618 100

E-maili: info@leasingalberti.com

